



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 1560 / Prot
1

Tiranë, më 8.3. 2022

UDHËZIM

Nr. 5 datë 8.3. 2022

PËR

NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020 "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" dhe vendimit nr. 112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor"", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020, i ndryshuar, pas pikës 5/4 të kreut VI, të shtohet pika 5/5 me përmbajtjen si më poshtë:

"5/5 "Përjashtimisht, aplikimet për programet e përbashkëta të studimit, me institucione të huaja të arsimit të lartë, për vitin akademik 2022–2023, do të pranohen deri më 29 prill 2022".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare"

MINISTRI

Evis KUSHI

